



USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 47 (827694)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 27 nëntor 2020

E para shqiptare që merr këtë post të rëndësishëm



Mimi Kodheli zgjidhet zëvendësprezidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Në Sesionin e 66-të Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (23 nëntor 2020), ku mori pjesë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, zonja Mimi Kodheli është zgjedhur zëvendës presidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Lajmin e bëri të ditur vetë NATO, ku në një njoftim shkruan:

“Sot, në Seancën e saj Plenare të datës 23 nëntor 2020, Asambleja Parlamentare e NATO-s zgjodhi (me unanimitet të plotë) zonjën Mimi Kodheli në postin e Zëvendësprezidentes së Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Zonja Mimi Kodheli, e cila është...”

» faqe 2

FA gëzojnë besimin e partnerëve dhe qytetarëve shqiptarë

Ka ikur koha kur FA përdorëshin për të prodhuar video-klipe



» faqe 3

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes Albert Mullai merr drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Xhaçka: “Gjeneral brigade Albert Mullait i është besuar drejtimi i një prej strukturave më të rëndësishme të FA, Akademisë së Forcave të Armatosura” » faqe 3



Poligoni Kombëtar i Bizës

Zhvillohet stërvitja “Rural Surveillance and Patrol Training”

Nga data 2 deri 20 nëntor në mjediset stërvitore të Batalionit të Forcave Speciale dhe Poligonit Kombëtar të Bizës u zhvillua stërvitja “Rural Surveillance and Patrol Training”. Kjo stërvitje u zhvillua me efektivët e Batalionit të Forcave Speciale shqiptare dhe një grupi të Batalionit të Dytë...



» faqe 2

Qendra Stërvitore, Pashaliman

Përfundon kursi “Dhënia e ndihmës së parë dhe kujdesi shëndetësor”

Në mjediset e Qendrës Stërvitore, Pashaliman, ka përfunduar me 20 nëntor 2020, kursi “Dhënia e ndihmës së parë dhe kujdesi shëndetësor”, i cili zgjati rreth 10 ditë. Trajnimi pati njohuri të rëndësishme teorike, gjithashtu kursantët i kanë demonstruar dhe në mënyre praktike për të qenë në gatishmëri dhe menjëhershme në dhënie të ndihmës...

» faqe 3

MISIONI I KOMBEVE TË BASHKUARA

VKM: Për praninë e misionit të Forcave të Armatosura në Sudanin e Jugut

» faqe 2

HISTORI

Nëntori i festave të mëdha

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

» faqe 4

Forumi Ndërkombëtar i Sigurisë, Halifax-Kanada

Përgjigja e NATO-s ndaj sfidave strategjike

» faqe 8



E PARA SHQIPTARE QË MERR KËTË POST TË RËNDËSISHËM

Mimi Kodheli zgjidhet Zëvendëspresidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Ambasadorja amerikane Yuri Kim, ka uruar deputeten Mimi Kodheli për zgjedhjen si Zëvendës Presidente në Asamblenë Parlamentare të NATO-s

Në Sesionin e 66-të Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (23 nëntor 2020), ku mori pjesë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, zonja Mimi Kodheli është zgjedhur zëvendës presidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Lajmin e bëri të ditur vetë NATO, ku në një njoftim shkruan: “Sot, në Seancën e saj Plenare të datës 23 nëntor 2020, Asambleja Parlamentare e NATO-s zgjodhi (me unanimitet të plotë) zonjën Mimi Kodheli në postin e Zëvendës-presidentes së Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Zonja Mimi Kodheli, e cila është aktualisht Kryetare e Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe Kryetare e Delegacionit parlamentar shqiptar

ne Asamblene NATO, bëhet kështu e para shqiptare që zgjidhet në një një pozicion të tillë të një organizate ndërkombëtare”.

Ndërkohë Ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, përmes një postimi në rrjetet sociale, ka uruar deputetin Mimi Kodheli për zgjedhjen si Zëvendës Presidente në Asamblenë Parlamentare të NATO-s. “Urime Mimi Kodheli për emërimin si Zëvendës Presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, shqiptari i parë që mban këtë post të rëndësishëm. Ne shpresojmë ta shohim atë duke punuar me Presidentin e Asamblesë Parlamentare Gerry Connolly, për të forcuar NATO-n!” shkruan Kim në Twitter. Mimi Kodheli ka mbajtur postin e Ministres së Mbrojtjes në vitet 2013-2017.



POLIGONI KOMBËTAR I BIZËS

Zhvillohet stërvitja “Rural Surveillance and Patrol Training”

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është shkëmbimi i eksperiencave dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet aleatëve të NATO

Nga data 2 deri 20 nëntor në mjediset stërvitore të Batalionit të Forcave Speciale dhe Poligonit Kombëtar të Bizës u zhvillua stërvitja “Rural Surveillance and Patrol Training”. Kjo stërvitje u zhvillua me efektivët e Batalionit të Forcave Speciale shqiptare dhe një grupi të Batalionit të Dytë të Regjimentit të

Dukës së Lankasterit (2LANCS) të Mbretërisë së Bashkuar.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është shkëmbimi i eksperiencave dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet aleatëve të NATO.

Stërvitje ishte konceptuar në dy faza: faza e parë teorike u fokusua në mësimdhënie dhe marrje njohurish, ndërsa faza e dytë përmbajti zhvillimin

e veprimeve praktike taktike.

Ndër temat kryesore që u zhvilluan në këtë stërvitje ishin: planizimi, zbulimi special, njohuri armatimi, xhenio, shëndetësi, patrullim në këmbë dhe me mjete, llojet e rendimeve të luftimit në këmbë dhe me mjete, rënie në kontakt me kundërshtarin, mbulimi dhe kamuflimi, zënia e pikës së vrojtimit, goditje objekti, etj.



Misioni i Kombeve të Bashkuara

VKM: Për praninë e misionit të Forcave të Armatosura në Sudanin e Jugut

Kohëzgjatja e misionit ushtarak shqiptar do të jetë deri në 22.9.2021

Këshilli Ministrave më datë 18 nëntor 2020, miratoi vendimin për “Nje ndryshim në vendimin Nr.270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), të ndryshuar”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurave të vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,



të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr.1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, miratuar me ligjin nr.23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi “në pikën 1, të vendimit nr.270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data 15.3.2021 ndryshohet dhe bëhet 22.9.2021”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

Republika e Sudanit të Jugut është një vend pa dalje në det në Afrikën Lindore. Kryeqyteti i Sudanit të Jugut është Xhuba. Kufizohet me Etiopinë në lindje, me Kenin, Uganden dhe Republikën Demokratike të Kongos në jug. Republika e Sudanit të Jugut e ka fituar pavarësinë më 9 korrik 2011 dhe ka rreth 8 milionë banorë.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Hajrie **DEDAJ**

Redaktore/ korrektore:
SUELA **HODO**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

Albert Mullai merr drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Gjeneral Brigade Albert Mullai ka marrë drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura. Lajmin e bëri të ditur ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cila tha se Mullait iu besua një detyrë shumë e rëndësishme, teksa i ka uruar dhe suksese në detyrë.

“Gjeneral brigade Albert Mullait i është besuar drejtimi i një prej strukturave më të rëndësishme të FA, Akademisë së Forcave të Armatosura. Suksese në detyrën e re komandant Mullai!”, - shprehet Xhaçka.

“Ju dhe çdo efektiv, pedagog dhe student i AFA keni gjithë mbështetjen tonë, për të çuar përpara një prej projekteve më të rëndësishme për të ardhmen e ushtrisë shqiptare”, - thekson Xhaçka. Përpara marrjes së kësaj detyre, Gjeneral Brigade Albert Mullai mbante postin e Komandantit të Forcave Tokësore.

Gjeneral brigade Albert Mullai ka lindur në Tiranë, më 23 shkurt 1964. Gjatë karrierës së tij si ushtarak ka kryer një sërë detyrash të rëndësishme si: Komandant i Akademisë së nënoficerëve “Thomson”, Këshilltar i lartë për Personelin pranë Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të FA Afgane ne kuadër të Misionit Resolute Support”-Kabul, Afganistan, Shef i Planifikimit Afatgjatë të Komandës Mbështetëse, Atashe

Xhaçka: “Gjeneral brigade Albert Mullait i është besuar drejtimi i një prej strukturave më të rëndësishme të FA, Akademisë së Forcave të Armatosura”



Ushtarak i Republikës së Shqipërisë në SHBA, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në MM, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik të Politikave të Personelit, Oficer Shtabi për Opera-

cionet dhe Stërvitjen në Përfaqësinë e Përhershme Ushtarake të RSH-së në NATO-Bruksel-Belgjikë, Oficer shtabi për Personelin (PSE Staff Element) në Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar IMS, të NATO-s



në Bruksel-Belgjikë, Shef i Sektorit të Arsimit të J1 në Shtabin e Përgjithshëm të FA, Shef i Sektorit të Marrëdhënieve dypalëshe në Drejtorinë e Politikave dhe Integritetit të MM-së, etj.

FA GËZOJNË BESIMIN E PARTNERËVE DHE QYTETARËVE SHQIPTARË

Ka ikur koha kur FA përdorëshin për të prodhuar video-klipe

Deklaratë për shtyp e Zyrës për Median në Ministrinë e Mbrojtjes

Tiranë 24 nëntor 2020: “Ndoqem sot me habi dhe indignatë një deklaratë të znj. Albana Vokshi, e cila përsëriste pa menduar disa akuza të pabaza për përdorimin e helikopterëve të FA për të bërë fushatë elektorale, ngritur nga një individ, i cili pasi dështoi të përfshihet në listat e kandidatëve për deputet të PD, sepse u refuzua me përbuzje nga anëtarësia e kësaj partie në qarkun e Dibrës, të cilët e njohin shumë mirë atë, karakterin dhe bëmat e tij, tenton tani të fitojë pikë me kryesinë e PD duke sajuar histori ala babale me helikopterë.

Akuza si këto, në fakt nuk meritojnë përgjigje, sepse janë inskenime të ulëta dhe përpjekje për të hedhur baltë e për të nxirë punën e mirë që është bërë në FA në këto vite. Por, në respekt të qytetarëve, duam të sqarojmë që në asnjë rast, as Ministri dhe asnjë zyrtar i lartë civil apo ushtarak i Dikasterit të Mbrojtjes, nuk ka përdorur për qëllime politike, elektorale apo personale, asnjë mjet të FA, e jo më pastaj helikopterët.

Duam t'i sqarojmë po ashtu qytetarët që jo vetëm Ministri, por edhe drejtuesit e FA kanë të drejtë, bazuar në ligj e procedura të mirëpërcaktuara, që



të përdorin në përmbushje të detyrave funksionale mjetet e FA, përfshirë helikopterët.

Në bazë të një plani lëvizjesh, helikopterët e FA, përdoren në mënyrë të rregullt, çdo ditë, për një sërë funksionesh, siç janë stërvitjet, evakuimet, monitorimet, inspektimet, emergjencat ajrore, udhëtimet e transporti për nevojat të FA etj. Gjithmonë në respekt të ligjit dhe gjithmonë duke lënë gjurmë të pakompromentueshme në sistem. E në këtë pikë, ia vlen të theksohet që ky përdorim do të kishte qenë

i papërballueshëm për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes nëse do të kushtonte 10.000 euro për fluturim siç pretendohet në akuzat e PD.

Jemi të keqardhur, që Partia Demokratike ka kthyer sot në kauzë të vetën, akuzat e pabaza e me motive politike, të një ish-ushtaraku të diskretituar, në kohën e të cilit vërtet mjetet e FA përdorëshin për qëllime personale e elektorale, nga kërkimi për thesare e deri tek video-klipet e këngëtarëve me helikopterët e ushtrisë. Për të mos folur pastaj, për skandalin e wikileaks, ku po ky zotëri, raportohej nga aleatët strategjikë të Shqipërisë se kërkonte 7.000 euro rryshfet nga djemtë e vajzat në uniformë që kërkonin të merrnin pjesë në misionet e NATO-s në Afganistan. Sot FA përjetojnë një realitet krejt tjetër. Ato gëzojnë besimin e partnerëve dhe qytetarëve shqiptarë, të cilët i vlerësojnë FA ne anketime si institucionin më të besuar për shqiptarët. Ne jemi të vendosur të vazhdojmë në rrugën e nisur, duke çuar përpara modernizimin dhe profesionalizimin e FA, larg modelit të së kaluarës, të cilit i përket autori i këtyre akuzave”.



QENDRA STËRVITORE,
PASHALIMAN

**Përfundon
kursi “Dhënia
e ndihmës
së parë dhe
kujdesi
shëndetësor”**

Në mjediset e Qendrës Stërvitore, Pashaliman, ka përfunduar me 20 nëntor 2020, kursi “Dhënia e ndihmës së parë dhe kujdesi shëndetësor”, i cili zgjati rreth 10 ditë.

Trajnimi pati njohuri të rëndësishme teorike, gjithashtu kursantët i kanë demonstruar dhe në mënyrë praktike për të qenë në gatishmëri të menjëhershme në dhënie të ndihmës së parë. Pjesëmarrës, ishte dhe komandant i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi Shtabit të Forcës Detare kapiten i rangut II Sabri Gjinollari, të cilët i kanë vlerësuar dhe me certifikata mirënjohje kursantët. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare, Pashaliman krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi.

Nëntori i festave të mëdha



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Festat kombëtare, apo datat për ngjarje të shënuara në jetën e një populli janë pjesë e qenësishme e historisë së tij. Ato përbëjnë, sipas rastit kulme në jetën e një populli. Festat e ngjarjet e rëndësishme, për nga karakteri, përmbajtja e rrjedhojat janë të ndryshme dhe të shtrira në kohë e ditë, data, muaj e vite. Ndoshta edhe në këtë fushë, ne shqiptarët, jemi të parët (fatmirësisht këtë radhë për mirë). Muaji Nëntor vetëm në dy ditë ka një denduri të madhe festash me përmasa të mëdha kombëtare. Ato nuk erdhën e nuk u bënë ngjarje të rëndësishme ashtu, vetvetiu. Në fund të këtij muaji e posaçërisht më 28 e 29 Nëntor, populli shqiptar ka “mbrujtur” hap pas hapi, rast pas rasti, me duart e tij e me përkushtim të shquar atdhetar, me gjakun e bijve e bijave të vet, me djersën e mendjen e tyre, katër festa të mëdha me vlera madhore kombëtare.

Nëntori i Parë-28, Nëntor 1443

Pas dëbimit të pushtimit serb të Stefan Dushanit në vitin 1355, në trevat shqiptare u krijuan disa principata feudale shqiptare, si të Balshajve në Durrës, të Gjini Bue Shpatës në Artë, të Zenebishtëve në Gjirokastrë dhe të Muzakajve në Berat dhe u shpallën të pavarura disa bashkësi qytetare. Vendi po shkonte drejt unifikimit. Hapin e parë e hodhën Balshajt duke shtrirë sundimin e tyre nga Tivari në Vlorë, Berat, Kostur e Shkodër. Por këto përpjekje u zhbënë shpejt pas humbjes së Balshajve në betejën e Savrës më 1385 në ndeshjen e parë me Turqinë të thirrur për ndihmë nga Karl Topia. Nga kjo kohë turqit iu vërsulën viseve shqiptare dhe, në fillim të shek. XV ata pushtuan gati gjithë viset shqiptare. Por pikërisht më 28 Nëntor 1443 Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në kryeqendrën e Krujës, ngriti flamurin e kuq me shkabën dykrenare duke rrëzuar atë me gjysmë hënë. Në këtë ditë të shënuar Skënderbeu iu drejtua shqiptarëve të entuziazmuar dhe do të deklaronte një të vërtetë, që shqiptarët do t'i shoqëronte në të gjithë historinë e tyre luftarake: “Lirinë nuk jua solla unë, por e gjeta në mes tuaj... Armët nuk ua ngjsha unë, por ju gjeta të armatosur; lirinë e kishit kudo në kraharror, në ballë, në shpata dhe në ushta”. Dhe vërtet, ky 28 Nëntor erdhi pas një sërë betejash të zhvilluara për gati 50 vjet, ku nën drejtimin e Gjergj Aranitit në vitin 1432, i shkaktoi humbjen e parë ushtrisë osmane në grykat e thella të Labërisë. Kjo do të shërbente si prelude i Nëntorit të parë shqiptar.

Nëntori i Dytë-28 Nëntor 1912

Gati 5 shekuj shqiptarët luftuan kundër pushtimit osman. Kryengritje pas kryengritjesh zhvilloi populli



shqiptar, për çlirimin nga sundimi osman. Pas vdekjes së Skënderbeut, sërish Shqipëria do të përbënte një vatër të ndezur antiosmane. Në këtë kuadër, duke u ndaluar në disa prej tyre të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm, mund të përmendim kryengritjen e nipit të Skënderbeut (1494-1506), më pas Vilajetin e Janinës të Ali Pashë Tepelenës dhe të Bushatllinjëve në Shkodër të cilat tronditën themelet e vet Perandorisë Osmane, Kryengritjen e Tanzimatit, ato të viteve 1910-1912 të cilat çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Në rezultat të kryengritjeve të pambarim, Shqipëria, gjatë sundimit të zgjatur osman, në tërësi mbeti në luftë të vijueshme.

Ndaj edhe ngritja e flamurit në këtë Nëntor të Dytë në Vlorë, edhe pse erdhi nëpërmjet rastësisë së zhvillimit të ngjarjeve, Vlorë dhe krahina që përfaqëson e meritonte këtë nderim të përjetshëm të simbolit të flamurit. Ajo do të vijonte me dinjitet rrugën e flamurit. Akti i burrit të shquar të gjithë Shqipërisë, Ismail Qemal Vlorës për ngritjen e flamurit e veçanërisht gëzimi i kësaj fitoreje historike, për vet ardhmërinë e Shqipërisë, nuk do të vazhonte gjatë. Nga njëra anë faktori ndërkombëtar me zgjidhjet e veta dhe për interesa të caktuara në kurriz të popullit shqiptar, shumicën e trojeve shqiptare i la jashtë shtetit amë, Shqipërisë. Ngjarjet rrodhën shpejt dhe qeverisë së Ismail Qemalit, ju vunë shkopinj nën rrota nga vetë politikanë të ndryshëm shqiptar. Po kështu edhe shpërthimi i Luftës së Parë Botërore e ktheu Shqipërinë në fushëbetejë duke vënë në pikëpyetje vet ekzistencën e shtetit të brishtë shqiptar. Gjithsesi vlerat e Nëntorit të Dytë, pavarësisht nga rrjedhat historike, hodhën themelet e shtetit shqiptar, e vendosi Shqipërinë, edhe pse të përgjysmuar në troje, në radhë e shteteve të pavarura. Pikërisht kjo pavarësi do të shërbente si garanci, që pas Luftës së Parë Botërore, Shqipëria e Nëntorit të Dytë të rimëkëmbjeve e tu qëndronte synimeve të fqinjëve, duke ardhur deri te Shqipëria e sotme. Programatike për shqiptarët mbetet porositë e Ismail Qemalit në ditën e ngritjes së flamurit kombëtar: “Ja pra, ky është

flamuri ynë i kuq e me shqiponjën dykrenore në mes. Dhe tani të gjithë bashkohuni si një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për të përparuar e për të qytetëruar, sikurse i ka hije Atdheut tonë të lirë”.

Nëntori i Tretë 29 Nëntor 1944

Më 7 Prill 1939 Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste. Fillimisht me qëndresë pasive e më pas aktive, populli shqiptar u ngrit si gjithnjë në histori në luftën çlirimtare. Në këtë kontekst, djem e vajza të Shqipërisë, vullnetarisht mbushën rreshtat e formacionet dhe dhanë gjakun e tyre jo vetëm në Shqipërisë, por deri në Kosovë, Mal të Zi e Bosnjën Jugore.

Në pikëpamje të forcës ushtarake Shqipëria, nuk trashëgoi asgjë nga ish ushtria mbretërore. Frontit Nacionalçlirimtar dhe Partisë Komuniste shqiptare, që mbeti e vetmja forcë politike aktive në luftën kundër fashizmit, ju desh që gjithçka ta fillonin nga elementet më fillestar të organizimit e të veprimit ushtarak. U organizuan njësitet guerrile, si elemente fillestare e më pas, nga fillimi i vitit 1942, u kalua në formimin e çetave atdhetare e partizane, të cilat kryen një sërë goditjesh dhe çliruan zona të tëra në gjithë Shqipërinë, që shërbenin edhe si baza të tyre. Populli shqiptar, duke parë te Fronti Nacionalçlirimtar forcën e vetme, që siguronte jo vetëm bashkimin në luftë, por edhe zhvillimin zgjerimin e saj, u rreshtua gjerësisht nëpër formacionet partizane. Kështu më 10 Korrik të vitit 1943 u krijua Shtabi i Përgjithshëm, ditë që u quajt edhe dita e themelimit të UNÇSH. Gradualisht u kalua nga çetat në batalione, brigada e në gjysmën e dytë të vitit 1944 edhe në divizione e korparmata.

Luftën e tij kundër pushtuesit populli shqiptar nuk e shikonte të shkëputur nga fati e lufta e popujve të tjerë të robëruar dhe në tërësi të Bllokut të Madh Antifashist Botërore. Viti 1942, veçanërisht gjysma e dytë e tij, shënuan disa ngjarje e akte që e afronin atë gjithmonë e më tepër me Aleatët e Mëdhenj. Akti i parë dhe shumë

domethënës, ishte padyshim Rezolucioni i Konferencës së Pezës. Ai përshkohej tej e ndanë nga fryma e parrullës së bashkimit në luftë të të gjithëve, pa dallim feje, krahine, ideje e seksi. Në të shprehej solemnisht se Shqipëria dhe Lëvizja NÇ qëndronin në krah të Kualicionit të Madh Antifashist. Kjo u pasua me një zgjerim të menjëherëshëm të formacioneve partizane e atdhetare dhe të veprimtarisë luftarake të tyre kundër forcave pushtuese. Në mënyrë të logjikshme Konferenca, me mesazhet që përcolli, por edhe me rezultatet që po binte në zgjerimin e luftës antifashiste, tërhoqi edhe vëmendjen e Aleatëve të Mëdhenj. Britania e Madhe, BRSS dhe SHBA, më 17 e 18 Dhjetor 1942, pavarësisht ndonjë nuance për ardhmërin e kufijve të pasluftës të shprehura nga anglezët, me deklarata të veçanta mbështetën fuqishëm LNÇ, duke e njohur atë publikisht si aleat në luftën e përbashkët.

Një akt tjetër, krahas krijimit e zgjerimit të UNÇSH dhe fuqizimit të luftës së armatosur, për nga vendimet që mori për vijimin e luftës, por edhe tepër domethënës i renditjes së Shqipërisë në krah të Aleatëve të Mëdhenj, ishte edhe mbajtja e Kongresit të Përmetit më 24 Maj 1944. Punimet e tij u zhvilluan duke mbajtur në sfond, krahas flamurit kombëtar e portreteve të atdheravë të shquar rilindas, edhe flamujt e tre Aleatëve të Mëdhenj dhe fotografitë e Rusveltit, Stalinit e Çërcillit. Në vendimet e tij theksohej solemnisht: “Populli shqiptar do të vazhdojë luftën krah për krahë me Aleatët e Mëdhenj dhe si pjesëtar i Bllokut Antifashist do të gëzojë të gjithë të drejtat që garantohen prej Kartës së Atlantikut, Konferencës së Moskës dhe Teheranit të firmosur prej udhëheqësve të mëdhenj Rusvelt, Stalin e Çërcill”. E njëjta frymë e këmbënguljes në krah të Aleatëve të Mëdhenj u përshkua edhe në dokumentet e aprovuara në Konferencën e Dytë të Këshillit Antifashist, mbajtur në Tetor 1944 në qytetin e Beratit.

Në shkallë ndërkombëtare Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar ishte pjesë përbërëse e luftës botërore antifashiste. Me luftën e vet heroike populli ynë i tregoi botës se Shqipëria

e vërtetë nuk ishte ajo që një grusht tradhtarësh e kishin shpallur “aleate të Boshtit”, por ajo që populli kryengritës, me Partinë Komuniste në krye, e kishte vënë veten në radhët e pjesëtarëve më aktivë të popujve dhe shteteve të koalicionit të madh antifashist, një popull prej afro 1 milion, që ngriti një ushtri çlirimtare prej qindra mijë luftëtarësh, që angazhoi në luftë 15 divizione italiane gjermane dhe u shkaktoi atyre mijëra të vranë, të plagosur dhe dëme të shumta materiale. Populli kryengritës shqiptar dërgoi edhe përtej kufijve shtetërorë mjaft luftëtarë të Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare, të cilët luftuan me vetëmohim për çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhe të vëllezërve shqiptarë të Kosovës.

Shqipëria nxorri rreth 70.000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha një zhvillim të madh Lëvizjes NÇ edhe në Kosovë ku u krijuan 9 brigada partizane dhe rreth 53.000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28.000 dëshmorë, krahas rreth 20.000 qytetarëve të masakruar, vranë e gjymtuar nga pushtuesit fashist e nazist. Në territorin shqiptar shkeli këmba e më së 700.000 trupave nazifashiste dhe u angazhuan rreth 15 divizione italiane e gjermane duke ju nxjerrë jashtë luftimit rreth 70.000 trupa. UNÇSH plotësoi më së miri misionin që mori mbi vete duke çliruar vendin pa qenë e nevojshme që në truallin e saj të futeshin formacione ushtarake të forcave aleate. Kjo përbën, në pamjen luftarake, ndihmesën e drejtpërdrejtë të popullit shqiptar në kuadër të Kualicionit të Madh Botëror Antifashist. Shqipëria mbajti kështu një peshë të rëndë në raport me popullsinë.

Në funksion të çlirimit të vendit nga pushtuesi dhe kuadrin e kësaj aleance, organet drejtuese të LNÇ, duke lënë mënjane mospajtimet për çështje të ndryshme me shtete fqinj apo edhe ngarkesat ideologjike, për një ideal më të madh, vendosën lidhje me Frontet NÇ të Jugosllavisë e Greqisë. Pranë Shtabit e Komandës sonë të Përgjithshme, në vijim të vlerësimit prej tyre të angazhimit tonë të pakompromis në Luftën Antifashiste e në krah të Aleatëve, në vitet 1943-1944 erdhën edhe përfaqësues ushtarakë të komandave ushtarake britanike, sovjetike dhe amerikane, duke dërguar edhe ne, në Shtabin Aleat të Mesdhut, përfaqësinë tonë. Madje, Shqipëria, besnike e angazhimit të saj në luftën e përbashkët, dërgoi edhe formacione të veta luftarake për çlirimin e trojeve shqiptare jashtë kufijve tokësorë si në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi e madje edhe deri në Bosnjën Jugore. Kështu SHP dhe Komanda e Përgjithshme e UNÇSH kreu me nder misionin e vet në luftën çlirimtare antifashiste jo vetëm ndaj popullit të vet, por edhe ndaj aleatëve dhe popujve fqinjë.

Festat e Nëntorit janë në vijim e zgjatje të njëra tjetër. Për vet rrjedhat historike të ngjarjeve, ato natyrshëm u vendosën në krahë e në shërbim të njëra tjetër dhe ne, i kujtojmë ato së bashku, si një ditë të vetme, si ditën e flamurit, si ditën e pavarësisë, si ditën e Shqipërisë së çliruar nga i huaji, por edhe të ngritur me duart, mendjen e zëmrat e njerëzve tanë.

Rëndësia e forcës Fizike në Ushtritë moderne

GJORGJI VELJOVSKI

Stresi fizik i luftës moderne nuk është reduktuar aspak më parë. Përkundrazi, ai është rritur relativisht saktësisht për shkak të nocionit të rremë se teknologjia dhe armatimet moderne do të lehtësojnë luftën. Ushitari i sotëm është mësuar sistematikisht me përfitimet e teknologjisë dhe ekziston një tendencë për të injoruar, ose relativizuar rëndësinë e forcës fizike. Ushtritë moderne gjithnjë e më shumë alarmohen për nevojën e ruajtjes së standardeve të aftësisë fizike, sepse ekziston një perceptim se vetëm disa specialitete kanë nevojë për forcë fizike. Pas mijëvjeçarëve të luftërave botërore, sot kuptimi dhe nevoja për forcë të zhveshur fizike po rishikohet. Trajnimi fizik zhvillon aftësi ushtarake që janë thelbësore për sigurinë personale të një ushtari dhe për kryerjen në mënyrë efektive detyrat luftarake. Shkathësitë themelore që çdo ushtar duhet të dijë janë akoma vrapimi, kërcimi, ngjitja, zvarritja, noti dhe ngritja e peshave.

Atletika konsiderohet mbretëresha e sporteve, sepse disiplinat e saj datojnë që nga kohërat antike dhe është një demonstrim i aftësive ushtarake. Karakteristikat fizike të ushtarit gjithmonë kanë qendruar si superiore ndaj atyre, që nuk ishin ushtarë. Sportistët e parë ishin ushtarë që garuan në vrapim, në hedhjen e shtizës dhe gurit, kërcim në distance dhe kërcim në lartësi, aktivitete që në atë kohë i kërkoheshin një ushtari në fushën e betejës. Maratoni i parë ishte Filipidisi, korrieri që barti mesazhin nga Maratona në Athinë për fitoren ndaj Persianëve në vitin 490 para Krishtit. Në kohët e lashta, palestra dhe ushtrimet fizike konsideroheshin si një virtut i njeriut. Platoni dhe Aristoteli theksuan ushtrimin dhe gjendjen fizike të njerëzve si një politikë shtetërore dhe strategji ushtarake dhe diçka, që ndikon në psikologjinë dhe jetën intelektuale të njerëzve.

Kjo filozofi u pranua gjithashtu nga romakët në thënien e famshme “Mens sana in corpore sano” (në një trup të shëndetshëm ekziston një mendje e shëndetshme). Ushtarët romakë njiheshin më shumë për aftësinë e tyre për të lëvizur dhe fortifikuar. Ndërtimi i kampeve pasoi menjëherë pas marshimit të qindra kilometrave me të gjitha pajisjet individuale dhe kolektive. Suksesi i ushtrisë romake ishte për shkak të disiplinës, e cila u mbajt me punë manuale. Kur nuk lëviznin dhe luftonin, legjionarët kaluan kohën duke ndërtuar infrastrukturë, stërvitje dhe trajnime. Ka shembuj të tjerë të panumërt nga historia, që konfirmojnë faktin se forca fizike ka qenë gjithmonë jo vetëm e qenësishme, por edhe thelbësore për luftën dhe ushtrinë. Njohja doktrinale e gatishmërisë fizike të ushtrive fillon me reformën e parë të madhe të çështjeve ushtarake në shekullin e XVII. në kohë kur krijoheshin shtetet moderne kombëtare, ushtritë profesionale dhe disiplina e fuqisë ushtarake. Stërvitja e ushtarit, në të cilën theksohej forca fizike, ishte për shkak të zhvillimit të aftësive operacionale në shekullin e XIX, ku lëvizshmëria në fushën e betejës ishte çelësi i fitores. Marshimet e gjata dhe të shpejta të ngarkesave ishin thelbësore në Luftërat Napoleonike.

Të luftuarit evoluon për shkak të mënyrës së përdorimit të luftës dhe mjeteve të përdorura, por natyra e luftës, siç përshkruhet më së miri nga Clausewitz, është «një fushë e sforcimeve fizike dhe vuajtjeve» dhe do të mbetet gjithmonë e pandryshuar



Trupat franceze mund të udhëtonin deri në 50 kilometra në ditë dhe të luftonin menjëherë. Napoleoni lëvizi njësitë brenda marshit një ditë. Ishte një risi në fushën e betejës, një përqendrim i shpejtë i të gjitha njësive në një moment pasi njëra prej tyre të kontaktojë me armikun. Kjo kërkonte forcë të madhe fizike. Lufta e Dytë Botërore pa mobilizimin më të madh të njerëzve për luftë në historinë njerëzore. Më pas u vu re për herë të parë që mënyra moderne e jetës, shkenca dhe teknologjia, kishin ndryshuar në mënyrë drastike karakteristikat fizike të ushtarëve. Makineritë, automjetet dhe mjetet e krijuara për të lehtësuar punën fizike dhe për të rritur produktivitetin kanë zvogëluar aftësitë fizike të një personi mesatar. Sot, efektet e mënyrës moderne të jetesës në aftësitë fizike janë edhe më të mëdha. Një person mesatar sot, nëse nuk merret me sport, nuk do të përmbushet normat e qëndrësës dhe forcës së një personi mesatar të së kaluarës, edhe pse për shkak të mjekësisë moderne ai është shumë më i shëndetshëm dhe ka një jetëgjatësi më të madhe. Ndër përpjekjet e para për të përfshirë forcën fizike në doktrinën ushtarake ishte manuali amerikan FM 21-20 i vitit 1946.

Pas analizës së stresit fizik në fushën e betejës gjatë Luftës së Dytë Botërore, ky manual vuri bazat e aftësisë ushtarake, ushtrimeve fizike, të cilat, ndryshe nga sportet, duhet të zhvillojnë ato karakteristika, që një ushtari i duhen vërtet gjatë luftës. Është identifikuar, që përveç forcës, qëndrueshmërisë dhe shkathësisë, një ushtar duhet të zhvillojë një ndjenjë të lidhshpimit, iniciativës, stabilitetit emocional dhe vullnetit për të fituar. Për herë të parë, janë futur pengesa që simulojnë terrenin në fushën e betejës. Ky rregull gjithashtu përcakton për herë të parë kriteret për kontrollin fizik për të monitoruar përparimin e ushtarit. Trajnimi ditor ushtarak lidhet drejtpërdrejt me aftësinë fizike. Fuqia fizike e një ushtari zvogëlon gjasat

e lëndimit gjatë stërvitjes. Përveç kësaj, ka shumë trajnime specifike që kërkojnë një nivel veçanërisht të lartë të aftësisë fizike.

Për të qenë në dispozicion të ushtrisë, disa shkolla dhe kurse ushtarake kërkojnë që të plotësohen kriteret të rrepta fizike. Dhe e gjithë kjo është larg stresit të vërtetë fizik në fushën e betejës në një luftë të vërtetë. Prandaj, forca fizike duhet parë si një domosdoshmëri dhe një parakusht për profesionin ushtarak. Trajnimi fizik në ushtri është një kombinim i pjesës teknike, mendore dhe fizike. Teknika është e nevojshme për të zhvilluar njohuri dhe aftësi në luftime, mentaliteti për të nxitur motivim dhe dëshirë për të fituar, dhe ana fizike për të fituar forcë dhe qëndrueshmëri. Efektiviteti në luftime varet kryesisht nga aftësia fizike. Ushitari pritë të ketë forcë të madhe, qëndrueshmëri, shkathësi dhe koordinim të trupit. Pavarësisht nga teknologjia, ushtari modern do të jetë ende në gjendje të udhëtojë në distanca të gjata me pajisje, armë dhe municione, pothuajse gjithmonë përtej terrenit të keq dhe në kushte të vështira atmosferike. Ngritja e sendeve të rënda është e zakonshme në profesionin ushtarak.

Detyra më e thjeshtë, siç është ngarkimi dhe shkarkimi i një kamioni, është një aktivitet fizik, që kërkon forcë dhe teknikë. Ushtarët vazhdojnë të kryejnë detyra të vështira, pavarësisht nga teknologjia dhe pajisjet moderne. Por roli më i rëndësishëm i aftësisë fizike është se ajo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë mendore dhe emocionale të moralit të ushtarit. Një ushtar që është i përgatitur fizikisht është më lehtë të merret me lodhjen, rraskapitjen fizike dhe angazhimin shumë ditor pa pushim. Forca fizike rrit vetëbesimin e një ushtari, sepse ai e di që ai është më elastik ndaj stresit fizik. Ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e qetësisë në momente të

vështira. Një njësi ushtarake është aq e fortë sa hallka më e dobët. Kjo nënkupton nevojën për punë ekipore në qasjen e ushtrimeve. Programi i ushtrimit duhet të harmonizohet në mënyrë të tillë që të gjithë në njësi të zhvillohen afërsisht me kriteret e kërkuara. Cilësia e njësive vlerësohet në përputhje me aftësinë fizike totale të të gjithë anëtarëve. Përvojat nga situatat reale kanë treguar se është shumë më e rëndësishme për komandantin nëse të gjithë në njësi përgatiten afërsisht në të njëjtin nivel sesa kur disa individë bëjnë përjashtime. Puna në ekip dhe fryma e ekipit duhet të pasqyrohen në të gjitha fushat, dhe kjo është veçanërisht e saktë kur njësia po përballlet me një sforcim të rëndë fizik. Kjo është arsyeja pse në ushtri është e rëndësishme të stërviteni së bashku në krahasim me vendosjen individuale të rekordeve. Në të gjitha ushtritë është vërtetuar se gjëja më e rëndësishme për zhvillimin e frymës kolektive të njësive ushtarake është stërvitja e përbashkët e sinkronizuar e mëngjesit. Kjo është një metodë për t'i sjellë të gjithë, në mënyrë kolektive, në një nivel të përafërt për sa i përket forcës fizike. Angazhimi i ushtarit për të ruajtur kulturën fizike, i kombinuar me një mënyrë jetese të shëndetshme, do të ndikojë drejtpërdrejt në efikasitetin e kryerjes së detyrave të përditshme e në përgjithësi, në gatishmërinë luftarake. Prandaj, detyra për udhëheqësin është të inkurajojë, mirëmbajë dhe forcojë këtë.

Drejtuuesi në çdo nivel duhet të sigurojë që ushtarët janë të përgatitur fizikisht, sepse ushtria është një profesion sfidues psikofizikisht. Kryerja e detyrave të përditshme në kohë paqeje dhe gjatë luftës kërkon një shkallë të konsiderueshme të forcës në këmbët, krahët, shpinën dhe barkun e ushtarit. Ushtrimet e rregullta dhe të forta rritin madhësinë dhe forcën e muskujve.

Është më mirë që ushtari të zbatojë stërvitje funksionale, e cila është simulim i aktiviteteve në kryerjen e detyrave të përditshme. Përmes arteve marcialle, një ushtar zhvillon aftësi specifike të tilla si shkathësi, vetëbesimi, gatishmëria, shkathësia dhe agresiviteti, dhe përmes vepërimitarive konkurruese të situatës ndërton punën ekipore, vullnetin për të fituar, solidaritetin dhe aftësinë për të menduar dhe vepruar shpejt nën presion. Në shumë vende të NATO-s, kohë dhe fonde të veçantë janë caktuar për të kryer kërkime dhe analiza të marrëdhënies midis rezultateve të punës së ushtarit dhe gatishmërisë së tij psikofizike.

Praktika tregon se ata ushtarë që janë të përgatitur psikofizikisht, kanë rezultate më të mira për sa i përket disa kriterëve në aftësitë profesionale, efikasitetin dhe shpejtësinë në kryerjen e detyrave, mendimin kritik, komunikimin me anëtarët e tjerë, forcën mendore, dhe përballimin e situatave stresuese. Trupi i njeriut duhet parë si një makinë e përbërë nga trupi dhe mendja (pjesa fizike dhe mendore). Të dy pjesët duhet të trajnohen në mënyrë të barabartë. Një ushtar, që ushtron çdo ditë ka më shumë energji sesa ai që nuk bën. Ushtrimet fizike të përditshme e mbajnë ushtarin zgjuar dhe energjik gjatë gjithë ditës. Në nivelin strategjik, duke ruajtur sistematikisht gatishmërinë fizike të ushtrisë, rreziku i lëndimit dhe sëmundjes zvogëlohet. Stresi i luftës moderne imponon nevojën që të gjithë ushtarët të jenë të aftë fizikisht, pavarësisht nga specialiteti i tyre. Në çdo gjini apo shërbim, kërkohet një nivel i lartë i aftësisë fizike, sepse herët a vonë, ushtari do të gjendet në një situatë ku jeta e tij dhe kryerja e detyrës do të varet nga ajo.

Në një njësi ushtarake, nëse jo të gjithë janë të përgatitur në të njëjtin nivel, ose standardi do të bjerë, ose ankthi do të rritet për shkak të shpërndarjes së pabarabartë të ngarkesës së punës. Një ushtar i përgatitur psikofizikisht mund të bëjë më shumë sesa ai që nuk është i përgatitur. Ushitari modern është i armatosur dhe i pajisur me mjete të shumta që peshojnë, dhe ato duhet të barten në fushën e betejës. Edhe në ato vende pune ku nuk ka pajisje dhe veshmbathje, nivelet e stresit mund të jenë të larta. Ushtarët e trajnuar psikofizikisht kanë provuar të jenë mëndërisht më të qëndrueshëm në situata kur kërkohet shumë punë brenda një kohe të shkurtër. Gatishmëria e lartë luftarake e një ushtari kërkon shëndet të mirë, forcë mendore, rezistencë ndaj lëndimit dhe qëndrueshmëri. Palestra fizike prek individin, por edhe ekipin. Njësia ushtarake është aq e fortë sa më e dobëta dhe aq e shpejtë sa ushtari më i ngadaltë.

Ligji Nr.36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”

(Vijon nga numri i kaluar)

Neni 37
Kriteret e kualifikimit

1. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kriteret e kualifikimit që lidhen me kapacitetet ligjore, gjendjen financiare dhe përshtatshmërinë teknike e profesionale të operatorëve ekonomikë. Për prokurimet që përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar dhe trajtohen si punë, mallra/pajisje, shërbime të klasifikuara, autoriteti kontraktor, përveç kriterëve të parashikuara në këtë pikë, specifikon në kriteret e kualifikimit edhe kërkesat e sigurisë, referuar legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

2. Për prokurimet që përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar dhe trajtohen si punë, mallra/pajisje, shërbime të klasifikuara, autoriteti kontraktor, përveç kriterëve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, specifikon te kriteret e kualifikimit edhe kërkesat e sigurisë, referuar legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

3. Autoriteti kontraktor duhet të specifikojë në njoftimin e kontratës kriteret e vlerësimit, të parashikuara në këto dispozita, që kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin, si dhe referenca të tjera, që lidhen me nivelin minimal të aftësive të nevojshme që kërkohet të përmbushen për kontrata specifike.

4. Operatorët ekonomikë kualifikohen për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, pasi të kenë përmbushur kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, si më poshtë:

a) Gjendja ekonomike e financiare:
i. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare të nevojshme për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet njërit prej dokumenteve të mëposhtme: vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale; - paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet; deklaratës së xhiros së përgjithshme të shoqërisë. Në rastet kur mungon deklarata e xhiros së përgjithshme, mund të pranohet deklarata e xhiros së realizuar nga veprimtari të ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet, për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare.

ii. Një operator ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e operatorëve të tjerë, kur është e nevojshme dhe për një kontratë të veçantë, pavarësisht natyrës ligjore të lidhjeve që ai ka me ta. Në atë rast ai duhet t'i provojë autoritetit kontraktor që disponon burimet e nevojshme, duke siguruar një angazhim nga ato entitete për atë qëllim.

iii. Nën të njëjtat kushte, një bashkim i operatorëve ekonomikë mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në këtë bashkim operatorësh.

iv. Nëse, për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti, ai mund të provojë situatën e tij ekonomike dhe financiare me anë të dokumenteve të tjera, që mund të konsiderohen të përshtatshme nga autoriteti.

b) Operatorët ekonomikë duhet të kenë dëshmi përshtatshmërie teknike e profesionale për realizimin e kontratës. Përshtatshmëria teknike dhe/ose profesionale e ofertuesve mund të sigurohet nga një ose disa mënyra, në varësi të natyrës, sasisë dhe/ose rëndësisë së objektit të prokurimit, si më poshtë:

i. Përkrahimi i pajisjeve teknike dhe masave të përdorura nga operatori ekonomik për sigurimin e cilësisë së mjeteve studimore dhe përkrahimi i rregullave të brendshme në lidhje me pronësinë intelektuale.

ii. Një kontroll i kryer nga një au-

Kriteret e përzgjedhjes së operatorëve dhe arsyet e skualifikimit

Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”, të ndryshuar”. Numri CELEX 32009L0081, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 216, datë 20.8.2009, faqe 76–136.



toritet kontraktor ose, në vend të tij, nga një organ kompetent zyrtar i vendit në të cilin është themeluar operatori ekonomik, subjekt i marrëveshjes me organin, i kapaciteteve prodhuese apo kapacitetit teknik të operatorit ekonomik dhe, nëse është e nevojshme, i mjeteve të studimit dhe hulumtimit, të cilat janë në dispozicion të tij, dhe masat e kontrollit të cilësisë që duhet të marrë.

iii. Në rastin e kontratave për punë, kontratave të shërbimit ose kontratave të furnizimit, të cilat mbulojnë aktivitete ose shërbime të vendosjes dhe instalimit, kualifikimet shkollore dhe profesionale të operatorit ekonomik dhe/ose ato të personelit menaxherial të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, ato të personit ose personave përgjegjës për ofrimin e shërbimeve apo të menaxhimit të punëve.

iv. Një përkrahim të mjeteve, materialeve, pajisjeve teknike, numrave të stafit dhe/ose burimeve të furnizimit (me një tregues të vendndodhjes gjeografike, kur ndodhet jashtë territorit të Bashkimit Evropian), të cilat operatori ekonomik i ka në dispozicionin e tij për të kryer kontratën, në rast të përballjes me ndonjë nevojë shtesë të kërkuar nga autoriteti kontraktor, si rezultat i një krize apo i kryerjes së mirëmbajtjes, modernizimit apo përshtatjes së furnizimeve të mbuluara nga kontrata.

v. Nën të njëjtat kushte, një bashkim i operatorëve ekonomikë mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në një bashkim operatorësh, duke bashkuar kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, në funksion të realizimit të objektit të kontratës. Kriteret e përcaktuara sipas kësaj pike duhet të jenë jodiskriminuese dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.

5. Në rastin e kontratave për punë, mallra/pajisje, shërbime, që për arsye sigurie përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi, përshtatshmëria, aftësia dhe kapacitetet e operatorit ekonomik për të pasur akses dhe për ta ruajtur e administruar këtë informacion në

përputhje me nivelin e klasifikimit të sigurisë, dëshmojnë tek autoriteti kontraktor nëpërmjet autorizimit dhe certifikatave të sigurisë, të lëshuara ose të konfirmuara nga autoriteti përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar.

6. Autoriteti kontraktor njeh certifikatat e sigurisë, të lëshuara nga institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë, ose të lëshuara nga autoritetet kompetente të sigurisë të vendeve të NATO-s, BE-së apo shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje sigurie, por vetëm pasi më parë të jetë bërë konfirmimi i vlefshmërisë së rekordeve përkatëse të këtyre certifikatave nga autoriteti përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar.

Neni 38
Arsyet/kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve

1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë çdo operator ekonomik kur ka të dhëna se ai është, ose ka qenë i dënuar me vendim penal të formës së prerë për ndonjë nga veprat e mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;
c) mashtrim;
ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste, vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, nxitje, ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste; dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;
ë) keqtrajtim i të miturve, sipas nenit 124/b të Kodit Penal, dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore. Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë, ose

bashkëshorti/bashkëshortja është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i operatorit ekonomik apo ka kompetenca përfaqësuese vendimmarrjeje, ose kontrolluese brenda tij.

2. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë çdo operator ekonomik, nëse:

a) ka falimentuar, apo është në likuidim, punët/çështjet e tij po administrohen nga një gjykatë, ka bërë marrëveshje me kreditorë, ka pezulluar aktivitetet e biznesit ose është në një situatë të ngjashme, të ardhur si pasojë e një procedure të ngjashme, sipas legjislacionit në fuqi;

b) është subjekt i procedimeve për deklarimin e falimentimit, për një urdhër likuidimi, apo administrimi të detyrueshëm nga një gjykatë apo një rregullimi me kreditorë apo ndonjë procedim të ngjashëm, sipas legjislacionit në fuqi;

c) nuk ka përmbushur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

ç) nuk ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

3. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë çdo operator ekonomik, nëse ai apo edhe përfaqësuesi i tij ligjor, pronari, aksionarët e tij janë gjetur, mbi bazën e provave apo të informacioneve të vërtetuara, duke përfshirë edhe ato të përfuturara nga burimet e mbrojtura me ligj, se përbëjnë rrezik të papranueshëm sigurie, apo nuk zotërojnë aftësitë dhe kapacitetet për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

4. Autoriteti kontraktor mund të përcaktojë, rast pas rasti, kriteret e tjera për kualifikimin e kandidatëve ose ofertuesve, në varësi të natyrës së procedurës së prokurimit.

5. Arsyet e skualifikimit të kandidatëve, ose ofertuesve listohen në njoftimin e kontratës që publikohet.

Neni 39
Përshtatshmëria për të ndjekur veprimtarinë profesionale

1. Nëse një kandidati i kërkohet të regjistrohet në një regjistrë tregtar ose profesional në shtetin e tij të origjinës apo të qëndrimit, në mënyrë që të ndjekë veprimtarinë/aktivitetin e tij profesional, atij mund t'i kërkohet të provojë regjistrimin e tij në një regjistrë të tillë, ose të japë një vetëdeklarim për të.

2. Në procedurat e dhënies së kontratave të shërbimit, nëse kërkohet që kandidatët të kenë një autorizim të veçantë, ose të jenë anëtarë të një organizmi të veçantë, në mënyrë që të jenë të aftë të kryejnë shërbimin e caktuar, autoriteti kontraktor mund të kërkojë paraqitjen e autorizimit, apo të anëtarësimit përkatës.

Neni 40
Standardet e sistemeve të menaxhimit

Standardet e sistemeve të menaxhimit të cilësisë nëse, në një procedurë prokurimi, nevojitet të vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me standarde të caktuara të menaxhimit të cilësisë, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet standardeve vendase/evropiane/ të NATO-s, të certifikuara nga organe të pavarura. Autoriteti kontraktor duhet të pranojë certifikata përkatëse, të lëshuara nga organizma të akredituar e të pavarur, dhe dëshmi të sistemeve të ngjashme me certifikimet CE dhe NATO.

Neni 41
Standardet e menaxhimit të mjedisit

Standardet e menaxhimit të mjedisit nëse autoritetet kontraktore do të kërkojnë respektimin e politikave mjedisore dhe/ose certifikata të hartuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë përputhshmërinë e operatorit ekonomik me standarde të caktuara të menaxhimit të mjedisit, ato duhet t'u referohen standardeve të menaxhimit të mjedisit, të bazuara në standarde të caktuara evropiane, ose ndërkombëtare, apo të barasvlershme me to.

Neni 42
Paraqitja dhe pranimi i ofertave

1. Autoriteti kontraktor përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave.

2. Kur autoriteti kontraktor jep sqarime, ose bën ndryshime në dokumentet e tenderit, ai vepron në përputhje me pikën 7, të nenit 30, të këtij ligji.

3. Vendimi për shtyrje të afatit përfundimtar u njoftohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet.

4. Ofertat dorëzohen me shkrim dorazi, ose nëpërmjet postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf.

5. Ofertat e marra pas mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së tyre u kthehen të pahapura ofertuesve, që i kanë paraqitur ato.

Neni 43 Hapja e ofertave

1. Autoriteti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes e këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesit, ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.

3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga autoriteti kontraktues, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë, për ata persona që janë të pranishëm, dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së prokurimit.

4. Procesverbal i duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm, ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

Neni 44 Shqyrtimi i ofertave

1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim, apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë, për këto korrigjime, ofertuesin, që ka paraqitur ofertën.

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat e specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur:

- ofertuesi nuk është i kualifikuar;
- ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, bërë sipas pikës 2, të këtij neni;
- oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Neni 45 Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret e ndryshme, të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jodiskriminuese.



2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.

4. Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 35, të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit.

5. Autoriteti kontraktor përcakton ofertën më të mirë pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Neni 46 Ofertat anomalisht të ulëta

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit, ose të shërbimeve të ofruara;
- zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave, apo të shërbimeve;
- origjinalitetin e punëve, të mallrave, apo shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin, dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Neni 47 Sigurimi i ofertës dhe sigurimi i kontratës

1. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, autoriteti kontraktor kërkon nga ofertuesit/kontraktorët, respektivisht, sigurimin e ofertës dhe sigurimin e kontratës.

2. Rastet e sigurimit të ofertës dhe të kontratës përcaktohen në rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Sigurimi i ofertës garanton autoritetin kontraktor nga veprime të papërgjegjshme të ofertuesit (tërheqjes ose ndryshimit të ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e tyre,

refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë).

4. Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë, ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

KREU VI KUSHTE TË VEÇANTA PËR KRYERJEN E KONTRATAVE

Neni 48 Kushte të veçanta për kryerjen e kontratave

1. Autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë kushtet e veçanta në lidhje me zbatimin e një kontrate, me kusht që këto të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos jenë drejtpërdrejt, apo tërthorazi diskriminuese.

2. Kushtet e referuara në pikën 1, të këtij neni, vendosen për mbrojtjen e sigurisë së informacionit të klasifikuar.

3. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kushtet e veçanta, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, në njoftimin e kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, dokumentet e kontratës, dokumentet përshkruese apo dokumentet mbështetëse.

Neni 49 Mbrojtja e sigurisë së informacionit të klasifikuar gjatë zbatimit të kontratës

1. Palët, gjatë zbatimit të kontratës, janë të detyruara që të zbatojnë tërësinë e masave për sigurimin e informacionit të klasifikuar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. Mospërmbushja e detyrimeve për zbatimin e kërkesave për sigurimin e informacionit të klasifikuar nga kontraktori, apo nënkontraktori përbën shkak për zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kontratës së klasifikuar nga autoriteti kontraktor.

3. Mospërmbushja e standardeve dhe e masave të sigurisë, të përcaktuara më parë në dakordësi me operatorët ekonomik, në zbatim të një kontrate të klasifikuar, përbën shkak që autoriteti kontraktor të bëjë zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj kontrate të klasifikuar.

4. Nëse, gjatë zbatimit të kësaj kontrate të klasifikuar, kontraktorit i hiqet CSI-ja nga autoriteti kompetent i sigurisë, autoriteti kontraktor bën zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj kontrate të klasifikuar, në çdo fazë të zbatimit të saj.

5. Në rastet kur, gjatë zbatimit të kontratës së klasifikuar, kontraktorit i mbaron afati i vlefshmërisë së CSI-së dhe autoriteti kompetent i sigurisë nuk lëshon CSI për kontraktorin, autoriteti kontraktor bën zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj kontrate të klasifikuar, në çdo fazë të zbatimit të saj.

të saj.

Neni 50 Siguria e furnizimit

1. Autoriteti kontraktor mund të përcaktojë në njoftimin e kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, në dokumentet e kontratës, dokumentet përshkruese apo dokumentet mbështetëse, kërkesa për sigurinë e saj.

2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë që oferta të përmbajë, ndër të tjera, të dhënat në lidhje me sigurinë e furnizimit, si më poshtë:

a) dokumentacion i demonstruar në mënyrë të pranueshme që ofertuesi do të jetë në gjendje për të respektuar detyrimet e tij në lidhje me eksportin, transferimin dhe tranzitimin e mallrave të lidhura me kontratë;

b) tregues të ndonjë kufizimi të autoritetit kontraktor në lidhje me zbulimin, transferimin ose përdorimin e produkteve dhe shërbimeve apo çdo rezultat të këtyre produkteve e shërbimeve, të cilat do të dalin nga kontrolli i eksportit ose masat e sigurisë;

c) dokumentacion i treguar se organizimi dhe vendndodhja e zinxhirit të furnizimit të operatorit ekonomik do të lejojë që ato të jenë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në lidhje me sigurinë e furnizimit, të përcaktuara në dokumentet e kontratës, dhe një angazhim për të siguruar që ndryshimet e mundshme në furnizimin e saj zinxhir gjatë zbatimit të kontratës nuk do të ndikojnë negativisht përputhjen me këto kërkesa;

ç) një angazhim nga ofertuesi që të krijojë dhe/ose ruajë kapacitetin e kërkuar për të përmbushur nevojat shtesë të kërkuara nga autoriteti kontraktor si rezultat i një krize, sipas termave dhe kushteve të rëna dakord;

d) çdo dokument mbështetës të marrë nga autoritetet kombëtare të ofertuesit në lidhje me plotësimin e nevojave shtesë të kërkuara nga autoriteti kontraktor si rezultat i një krize; 27 dh) një angazhim nga ofertuesi për kryerjen, mirëmbajtjen, modernizimin apo përshtatjen e furnizimeve të mbuluara nga kontrata;

e) një angazhim nga ofertuesi që të informojë autoritetin kontraktor në kohën e duhur për çdo ndryshim në organizatë, zinxhirin e furnizimit apo strategji industriale që mund të ndikojnë në detyrimet e tij kundrejt autoritetit kontraktor;

ë) një angazhim nga ofertuesi që t'i sigurojë autoritetit kontraktor, në bazë të termave dhe kushteve të rëna dakord, të gjitha mjetet e nevojshme, të veçanta, për prodhimin e pjesëve rezervë, përbërëse, dhe pajisjeve të veçanta të testimit, duke përfshirë vizatimet teknike, skicimet, licencat dhe udhëzimet për përdorim, në rast se asnjë njeri i vetëm nuk është në gjendje t'i ofrojnë këto furnizime.

3. Kur autoriteti kontraktor vlerëson se ofertuesi nuk i plotëson kërkesat për sa i përket sigurisë së furnizimit të përmendur në këtë nen, vendos, sipas rastit, skualifikimin e tij nga procedura ose zgjidhjen e kontratës, duke theksuar

arsyet e vendimit të tij.

KREU VII ZBATIMI I KONTRATËS

Neni 51 Kushtet për zbatimin e kontratës

1. Autoriteti kontraktor mund të cakttojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës, ose në dokumentet e tenderit, si dhe në përputhje me specifikat tekniko-operacionale të projektit/kontratës.

2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jo diskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

3. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuara me ligj mund të mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, apo nënkontraktorit, vendin e zbatimit, afatet dhe cilësinë e punimeve, të mallrave, apo shërbimeve në përputhje me kushtet e kontratës, legjislacionin në fuqi dhe nivelin e klasifikimit.

4. Respektimi i detyrimeve kontraktore dhe mbikëqyrja e zbatimit të kontratës në tërësi është detyrë e strukturës/sectorit të ngritur pranë autoritetit kontraktor për këtë qëllim. Kjo strukturë/sector vlerëson realizimin e detyrimeve kontraktuale, sipas fazave të realizimit të kontratës dhe përgatit raportin përkatës për titullarin e autoritetit kontraktor, për fazën në të cilën ndodhet zbatimi i kontratës. Gjatë zbatimit të kontratës, struktura raporton edhe tek organet kompetente për transferimet e mallrave e të pajisjeve ushtarake dhe atyre me qëllim të dyfishtë. Në çdo rast, struktura raporton brenda 5 ditëve nga marrja e informacionit me shkrim nga përdoruesi i fundit dhe/ose strukturat e varësisë. Në përfundim të kontratës, kjo strukturë/sector përgatit një raport përmbledhës për titullarin e autoritetit kontraktor mbi korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

5. Autoriteti kontraktor, për kontrollin dhe testimin e mallit, mund të blejë shërbim të konsulencës nga struktura të pavarura, me përvojë, dhe të licencuara në fushën përkatëse.

Neni 52 Nënkontraktimi

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i lirë për të zgjedhur nënkontraktorët që synon të nënkontrakttojë, me përjashtim të rastit kur autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesa të veçanta në lidhje me pikat 2, 3 dhe 4, të këtij neni. Autoriteti kontraktor nuk mund t'i kërkojë fituesit të tenderit të diskriminojë nënkontraktorët e mundshëm mbi bazën e kombësisë.

2. Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës, ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontrakttojnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar, si dhe objektin e nënkontratave për të cilat ai propozohet.

3. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përputhje me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 30% të vlerës së përgjithshme të kontratës.

4. Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni.

5. Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit kontraktor, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij/saj dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Forumi Ndërkombëtar i Sigurisë, Halifax-Kanada

Përgatiti: MSC. MIMOZA GOLIKJA

Përgatitja e Aleancës për të ardhmen me iniciativën NATO 2030 dhe përdorimi i saj për të adresuar rritjen e Kinës, kërcënimet kibernetike dhe sfida të tjera, ishin temat kryesore të pjesëmarrjes së Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë Halifax (22 nëntor 2020). Sekretari i Përgjithshëm u angazhua në një bisedë në internet me Robin Shepherd, Nënkrjetari i Forumit. Diskutimi hapi Sesionin Plenar të Forumit mbi “75 Vjet: Ri-Bërja e Rendit Botëror Demokratik”.

Intervista e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg për Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë Halifax

Administrata e SHBA ka folur për një tërheqje nga Afganistani. Por ju keni shprehur disa shqetësime rreth tërheqjes shumë shpejt si dhe një rritje të mundshme të IS dhe grupeve shoqëruese të terrorit. A keni mundur të merrni sqarime të mëtejshme nga Shtëpia e Bardhë për këtë?

Pozicioni i SHBA është i qartë; ata do të zvogëlojnë praninë e tyre në Afganistan nga afërsisht 4,500 në rreth 2,500 trupa. Asnjë aleat i NATO-s nuk do të donte të qëndronte në Afganistan më gjatë sesa ishte e nevojshme. Në të njëjtën kohë, nëse largohemi shumë herët, nëse largohemi shumë të nxituar, mund të rrezikojmë të humbasim të gjitha fitimet që kemi bërë; dhe ky është një projekt i rrezikshëm. Pra, ajo që është e qartë tani është se SHBA do të zvogëlojë forcat, por ata nuk do të largohen. SHBA do të vazhdojë të sigurojë mbështetje për aleatët e tjerë të NATO-s. Ne duhet të kujtojmë se më shumë se gjysma e trupave në Afganistan tani janë jo të SHBA-së ata janë aleatë evropianë dhe gjithashtu kombe partnere. Ne jemi në Afganistan për t'u siguruar që Afganistani kurrë nuk bëhet më një strehë e sigurt për terroristët ndërkombëtarë, një platformë ku terroristët mund të planifikojnë, organizojnë, financojnë, të fillojnë sulme terroriste kundër vendeve tona. Por në të njëjtën kohë, ne mbështesim fuqimisht bisedimet e paqes, të cilat po zhvillohen midis Talibanëve dhe qeverisë. Dhe një pjesë e marrëveshjes midis SHBA dhe Talibanëve është që të gjitha trupat ndërkombëtare duhet të jenë jashtë deri në 1 maj të vitit të ardhshëm. Kështu që në fillim të vitit të ardhshëm, ne duhet të marrim një vendim shumë të vështirë. Kjo është: nëse largohemi dhe rrezikojmë të humbasim fitimet që kemi bërë, por të paktën të mund të jemi jashtë Afganistanit; apo nëse qëndrojmë dhe pastaj vazhdojmë të përfshihemi në operacionin ushtarak shumë sfidues dhe kërkues në Afganistan. Mesazhi im është që ne duhet të vlerësojmë nëse plotësohen kushtet për largim. së bashku. Ne duhet t'i marrim këto vendime së bashku. Dhe siç kemi thënë shumë herë në NATO: kemi shkuar në Afganistan së bashku, duhet të marrim vendime për rregullimet e një pranie atje së bashku, dhe kur të jetë koha e duhur duhet të largohemi së bashku, por pastaj në një mënyrë të koordinuar dhe të rregullt.

Si kurrë më parë, në çdo gjë që ka të bëjë me Afganistanin, ka shumë pjesë në lëvizje. Njëra natyrisht, është transferimi i pushtetit në SHBA. A keni qenë në kontakt me Presidentin e zgjedhur Biden ose ekipin e tij?

Unë e kam uruar Presidentin e zgjedhur Joe Biden. Unë gjithashtu përgëzoja Zëvendës Presidentin e zgjedhur, Kamala Harris. Unë e njoh Joe Biden si një mbështetës të fortë të NATO-s, të lidhjes transatlantike, bashkëpunimit midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Unë kam pasur privilegjin të punoj me të në cilësinë e tij të mëparshme si Zëvendës President dhe mezi pres të punoj me të. Ekipi im është në kontakt me ekipin e tij. Në të njëjtën kohë, ne jemi shumë të vetëdijshëm se në SHBA, si në të gjitha vendet tona, ka vetëm një President në të njëjtën kohë. Kështu që ne punojmë me administratën aktuale. Unë kam qenë në kontakt të ngushtë me ta tani pasi ata kanë vendosur të rregullojnë praninë e tyre në Afganistan. Pastaj pres me padurim të punoj me një administratë të re të Biden

Përgjigja e NATO-s ndaj sfidave strategjike

Sekretari i Përgjithshëm diskutoi përgjigjen e NATO-s ndaj sfidave strategjike në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë Halifax



pas inaugurimit në 20 janar.

Pas pranimit të Maqedonisë së Veriut, NATO ka 30vende anëtare dhe siç e përmendët një pjesë e konsiderueshme e trupave në Afganistan nuk janë amerikane. Nëse pas vendimit të SHBA numri zbret në një nivel që ju si Sekretar i Përgjithshëm mendoni se është e rrezikshme, a mund të vendosin 29 kombet e tjera, për trupa shtesë?

Mendoj se duhet të kujtojmë pse shkua në Afganistan. Ne shkua në Afganistan pas një sulmi në SHBA dhe kjo është arsyeja pse të gjithë kemi qenë atje për gati 20 vjet. Më shumë se një mijë ushtarë jo-amerikanë kanë paguar çmimin më të lartë, çmimin përfundimtar. Dhe SHBA, natyrisht, por edhe aleatët dhe partnerët e NATO-s kanë paguar një çmim të lartë me gjak për praninë tonë në Afganistan. Ne kemi arritur gjënë më të rëndësishme, dhe kjo është të parandalojmë Afganistanin të jetë një strehë e sigurt për terroristët ndërkombëtarë. Por në të njëjtën kohë, ne do të dëshironim të largoheshim kur kushtet të jenë të përshtatshme. Dhe kjo është pikërisht ajo që ne do të vlerësojmë së bashku në fillim të vitit të ardhshëm dhe pastaj të marrim vendime së bashku nëse do të qëndrojmë ose nëse do të largohemi dhe pasi të jetë e

sigurt që ne do ta bëjmë atë, të gjithë aleatët, natyrisht, duke përfshirë SHBA.

Në aspektin ndërkombëtar, Kina është një fuqi në rritje. Askush nuk dyshon në këtë. Askush nuk konteston se ka ndonjë arsye pse nuk duhet të jetë një fuqi në rritje, që ekonomia e saj do të kapërcejë SHBA-në në një moment, ndoshta drejt fundit të kësaj dekade. Padyshim që po rrit shpenzimet e saj ushtarake. Deri në çfarë mase Kina paraqet një sfida strategjike ndaj NATO-s?

Kina nuk është armike dhe Kina nuk është kundërshtarë. Por sigurisht, ngritja e Kinës ka pasojë për aleatët e NATO-s dhe NATO-n. Ka mundësi të mëdha, jo më pak mundësi ekonomike. Kina është një ekonomi e madhe, në rritje, ajo siguron tregje për të gjithë aleatët e NATO-s dhe në të vërtetë ka ndihmuar në nxitjen e rritjes ekonomike edhe në vendet e NATO-s.

Por në të njëjtën kohë, ka disa sfida. Kina tashmë ka buxhetin e dytë më të madh të mbrojtjes në botë. Ata po investojnë shumë në aftësi të reja moderne, përfshirë aftësi bërthamore, raketa që mund të arrijnë në të gjitha vendet e NATO-s, aftësi detare. Ne gjithashtu shohim që Kina është një vend që nuk i ndan vlerat tona: demokracia, sundimi i ligjit, në mënyrën se si ne besojmë

në të në NATO. Ne kemi parë që kur bëhet fjalë për shembull, mënyra se si ata merren me Hong Kong, duke minuar të drejtat demokratike të njerëzve që jetojnë atje, uigurëve, pakicave. Por ne gjithashtu e kemi parë atë në mënyrën se si Kina përpiqet të detyrojë, të frikësojë fqinjët, si në rajonin në Detin e Kinës Jugore, por gjithashtu, për shembull, se si ata u përpoqën të ndëshkonin Australinë për ngritjen e disa çështjeve në lidhje me koronavirusin; ose vendi im – Komiteti Norvegjez i Nobelit i dha Çmimin e Paqes një disidenti kinez disa vjet më parë dhe pastaj për shumë e shumë vite, Kina u përpoq të na detyronte të shprehnim një justifikim publik për atë vendim. Pra, e gjithë kjo është, natyrisht, një sfida. Dhe për mua, kjo thjesht e bën NATO-n më të rëndësishme sepse kur qëndrojmë së bashku, të gjithë aleatët e NATO-s, ne jemi 50 përqind e PBB-së botërore, 50 përqind e fuqisë ushtarake të botës. Madhësia ka rëndësi, veçanërisht kur diskutohet për pasojat e rritjes së Kinës.

Në çfarë mase ka unitet brenda NATO-s për Kinën?

Pra, ne sapo kemi nisur një projekt të cilin ne e quajmë NATO 2030, që ka të bëjë me të ardhmen e NATO-s. Dhe ai projekt, natyrisht, do të trajtojë shumë çështje të ndryshme. Por një nga çështjet që duhet të trajtojmë janë pasojat e rritjes së Kinës. Dhe unë besoj fuqimisht se, nëse ka ndonjë gjë, ngritja e Kinës thjesht e bën NATO-n më të rëndësishme dhe unitetin midis aleatëve të NATO-s më të rëndësishëm. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me sfidat ushtarake, por edhe me internetin. Bëhet fjalë për qëndrueshmërinë e telekomunikacionit tonë të infrastrukturës, ku ne shohim që Kina po investon shumë. Gjithashtu ka të bëjë me qëndrimin së bashku, kur mbështesim vlerat tona dhe mendoj se të gjithë kemi disa mësimet për të mësuar. Unë isha Kryeministër në atë kohë në Norvegji kur Kina u përpoq të na detyronte të dorëzoheshim, ne ishim në gjendje të ngriheshim kundër këtij presioni. Por është e vështirë, dhe është e vështirë kur Kina zgjedh një nga një. Prandaj, nëse ka ndonjë gjë, unë besoj se NATO duhet të bëhet një platformë edhe më e fortë politike për bashkimin e aleatëve, por edhe partnerë, për t'u ngritur kur Kina përpiqet të detyrojë, t'u detyrojë atyre një politikë ose t'i detyrojë të bëjnë diçka që është në interesat e saj. Prandaj, ne po punojmë gjithnjë e më ngushtë me partnerët tanë në Azi-Paqësor. Kohët e fundit vizitova Japoninë, Korenë e Jugut, Australinë, Zelandën e Re, të gjithë partnerët të NATO-s, dhe ata të gjithë shprehën një vullnet të fortë për të punuar më ngushtë me NATO-n dhe ne jemi të

gatshëm ta bëjmë këtë.

Për 30 vjet pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ekzistonte një besim se ekonomia kapitaliste do të çonte në mënyrë të pashmangshme në demokraci politike, por kjo nuk ka ndodhur. NATO po qëndron në rajonin Euro-Atlantik si një organizatë. Ju nuk po kërkonin anëtarë jashtë në Azi ose rajonin Indo-Paqësor. Po bashkëpunimi midis demokracive që NATO është një pjesë integrale? Cilat janë mendimet tua për këtë?

NATO është një Aleancë rajonale, Amerika e Veriut dhe Evropa, dhe ne duhet të mbetemi një Aleancë rajonale. Në të njëjtën kohë, NATO si një Aleancë rajonale ka nevojë për një qasje më globale, sepse kaq shumë sfida, kërcënime me të cilat përballemi, janë gjithnjë e më globale: terrorizmi, kibernetika, hapësira, lufta hibride, përhapja e armëve bërthamore dhe më pas ngritja e Kinës, janë të gjitha sfidat globale që kanë rëndësi për të gjithë aleatët e NATO-s. Kështu që unë mendoj se është absolutisht e mundur që NATO të mbetet një organizatë rajonale, por në të njëjtën kohë të punojë gjithnjë e më afër me vendet me të njëjtat mendime në të gjithë botën, por duke përfshirë edhe rajonin e Azi-Paqësorit. Besoj fuqimisht se demokracitë e botës duhet të qëndrojnë së bashku. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ne pamë disa dekada ku gjithnjë e më shumë vende u bënë demokratike. Gjithnjë e më shumë njerëz jetonin në shoqëritë demokratike. Tani kemi parë që trendi zhvendoset paksa në drejtim të gabuar. Kështu që e bën edhe më të rëndësishme që vendet që besojnë në demokraci, në shtetin e së drejtës, duhet të qëndrojnë së bashku, veçanërisht kur shohim presion nga jashtë, nga vendet që nuk ndajnë ose nuk ndajnë vlerat tona, si, për shembull, Kina.

Anëtarësimi i Maqedonisë të Veriut në NATO, e çoi numrin në 30, një Aleancë e shëndetshme dhe në zgjerim. Një nga kritikant nga pala amerikane, është se vendet e NATO-s nuk kanë shpenzuar sa duhet në mbrojtje. Por që nga Samiti i Cardiffit në 2014, ka pasur progres. Ku jeni me rekomandimin për të shpenzuar 2% të PBB-së dhe si do shkojë kjo në vitet e ardhshme?

Pra, së pari, unë e mirëpres faktin që dera e NATO-s është e hapur dhe se tani kemi një anëtar të ri, Maqedoninë e Veriut. Ministria e Mbrojtjes, Zëvendës Kryeministria, Radmila Sekerinska, ajo është me të vërtetë një ambasador e shkëlqyer për vendin e saj. Ajo dikur ishte zëvendës Kryeministër, nuk mendoj se ajo është ende, por të paktën është ministër e Mbrojtjes dhe do të marrë pjesë në Forumin Halifax dhe mendoj se kjo është vetëm një mënyrë për të demonstruar rëndësinë e një aleati të NATO-s, Maqedonia e Veriut. Pastaj, në ndarjen e barrës, kjo është një fushë ku, në të vërtetë, kemi bërë përparim të rëndësishëm. Nuk po them se ne jemi atje ku duhet të jemi, por ne jemi në një vend shumë më të mirë sesa ku ishim vetëm disa vjet më parë. Sepse që kur kemi marrë vendimin në 2014 në lidhje me shpenzimet më shumë për mbrojtjen, ndarjen me të drejtë të barrës, të gjithë aleatët e NATO-s në të gjithë Evropën dhe Kanadanë janë rritur. Më shumë aleatë të NATO-s përmbushin udhëzimet për të shpenzuar dy përqind të PBB-së në mbrojtje dhe shumica kanë plane për të shpenzuar dy përqind. Vetëm gjatë viteve të fundit, ne kemi shtuar dhjetëra miliarda dollarë në shpenzimet tona të mbrojtjes, në buxhetin tonë. Pra, ky është një lajm i mirë, kryesisht sepse tregon se NATO, në të vërtetë, ne jemi 30 aleatë të cilët jemi të përkushtuar dhe kur vendosim diçka, ne jemi në gjendje ta bëjmë. Dhe kjo është pikërisht ajo që ne kemi bërë gjatë viteve të fundit.

25 VJETORI I MARRËVESHJES SË PAQES TË DEJTONIT

Stoltenberg: NATO do të vazhdojë të mbështesë Bosnjë-Hercegovinën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s shënoi 25 vjetorin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit dhe nënvizoi rëndësinë e partneritetit të vazhdueshëm me Bosnjë-Hercegovinën. Jens Stoltenberg theksoi përpjekjet e gjata të NATO-s në mbështetje të sigurisë dhe stabilitetit rajonal të Bosnjë-Hercegovinës (21 nëntor 2020) . “25 vjet më parë, Marrëveshja e Paqes e Dejtonit i dha fund gati katër viteve të luftës brutale në Bosnjë-Hercegovinë”, tha Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg. “Prania e trupave të NATO-s luajti një rol qendror në sjelljen e palëve ndërluftuese në tryezën e negociatave; sapo të nënshkruhej marrëveshja, forcat

e NATO-s mbikëqyrnin zbatimin e saj; dhe ne kemi qëndruar në terren që nga ajo kohë për të ndihmuar në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor”, shtoi ai. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerësoi Bosnjë-Hercegovinën për kontributet e saj në sigurinë Euro-Atlantike dhe vuri në dukje rolin e NATO-s në mbështetje të procesit të reformimit të institucioneve të sigurisë kombëtare të vendit. “Një nga arritjet më të rëndësishme ka qenë krijimi i Forcave të Përbashkëta të Armatosura; në fund të luftës ka qenë më shumë se 400.000 trupa, e ndarë në mes të tri ushtrive; sot ka një ushtri të vetme profesionale me rreth 10,000 ushtarë

dhe 5,000 rezervistë nën një zinxhir komandues të unifikuar”, nënvizoi ai.

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg theksoi gjithashtu angazhimin e vazhdueshëm të NATO-s. “25 vjet më vonë, ka ende shumë punë për të bërë” tha ai. “Ne nuk mund – dhe nuk duhet të kthehemi në të kaluarën; kompromisi mund të jetë i vështirë, por është me rëndësi jetike në qoftë se qytetarët e këtij vendi do të kenë jetën që ata meritojnë; NATO do të vazhdojë të mbështesë Bosnjë-Hercegovinën; një çerek shekulli pas Dejtonit, është koha të ribashkohemi për paqe, për të reformuar dhe për një të ardhme të begatë për të gjithë”, shtoi ai.

Sesioni i 66-të Vjetor i Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Tre prioritet dhe përshtatja e NATO-s për 2030 e më tej

Qëllimi i prioriteteve për NATO-2030 janë që kjo të mbetet një Aleancë e fortë ushtarake

Duke folur në Sesionin e 66-të Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (23 nëntor 2020), Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se iniciativa e NATO-s 2030, “do ta bëjë Aleancën tonë të fortë edhe më të fuqishme dhe të përshtatshme për të përballuar çdo sfidë, në dekadën e ardhshme dhe më gjerë” dhe shtoi se “NATO është i vetmi vend ku vendet e Evropës dhe Amerikës së Veriut takohen çdo ditë. Ne duhet të bazohemi në këtë dhe të përdorim NATO-n edhe më shumë si një forum për diskutim të sinqertë, mbi një gamë të gjerë të çështjeve të sigurisë”.

Fjalim nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në Sesionin e 66-të Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Për herë të fundit iu drejtova Sesionit tuaj Vjetor një vit më parë në Londër. Që nga ajo kohë, COVID-19 ka ndryshuar jetën tonë në mënyra që mezi mund t'i imagjinonim. Asnjë nga vendet dhe komunitetet që ju përfaqësoni nuk kanë mbetur të paprekur. Aleatët e NATO-s dhe ushtarakët tanë kanë mbështetur njëri-tjetrin dhe partnerët tanë gjatë gjithë kësaj pandemie, me transportimin e mjeteve kritike mjekësore, pacientëve dhe ekspertëve, vendosjen e spitaleve ushtarake në terren dhe sigurimin e kufijve, mbështetje e përpjekjeve civile dhe ndihma për të shpëtuar jetë. Ndërsa tani përballemi me valën tjetër, NATO ka krijuar një rezervë furnizimesh mjekësore në Itali, që tashmë po përdoret për të siguruar aleatët në nevojë. Vetëm në javët e fundit, ne kemi shpërndarë qindra respiratorë shtesë për aleatët tanë në Shqipëri, Republikën Çeke, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut dhe ne jemi të gatshëm të ofrojmë ndihmë të mëtejshme.

Në të njëjtën kohë, ne qëndrojmë vigjilentë dhe të gatshëm. Për shkak se përgjegjësia kryesore e NATO-s është të sigurohet që kjo krizë shëndetësore të mos bëhet një krizë sigurie. Gatishmëria jonë ushtarake është mbështetur dhe misionet dhe operacionet tona vazhdojnë nga grupet tona të betejës në lindje të Aleancës, në Kosovë, Afganistan dhe Irak.

Ky është adaptimi më i mirë i NATO-s dhe kjo është ajo për të cilën unë dua të flas me ju sot; Si NATO mund të vazhdojë të evoluojë, përballë një bote gjithnjë e më të pasigurt.

Dhjetorin e kaluar, udhëheqësit e NATO-s më kërkuan të bëj një reflektim që shikon përpara, për të provuar të ardhmen e Aleancës tonë. Kjo është arsyeja pse unë fillova NATO 2030. Për ta bërë Aleancën tonë të fortë edhe më të fuqishme dhe të aftë për të përballuar çdo sfidë, në dekadën e ardhshme dhe më gjerë. Prioritetet e mia për NATO 2030 janë: Për të siguruar që NATO mbetet një Aleancë e



fortë ushtarake; Bëhet më e fortë politikisht; Merr një qasje më globale. Më lejoni të përshkruaj shkurtimisht secilën prej tyre.

Së pari, ne tashmë jemi një Aleancë e fortë ushtarake

Në fakt, vitet e fundit kemi pasur rritjen më të madhe të mbrojtjes sonë kolektive për një brez, me më shumë investime, aftësi moderne dhe gatishmëri më e lartë e forcave tona. Kjo duhet të vazhdojë. Unë e di që vendosja e përparësive për shpenzimet e mbrojtjes në mes të një krize shëndetësore nuk është e lehtë. Por kërcënimet që ekzistojnë para pandemisë nuk janë pakësuar, përkundrazi. Kështu që angazhimi që kemi bërë të gjithë për të investuar më shumë në mbrojtje është po aq i rëndësishëm sa kurrë më parë. Një nga arsyet që na duhet një ushtri e fortë është lufta jonë kundër terrorizmit ndërkombëtar, siç kemi bërë në Afganistan për gati 20 vjet.

Siç e dini, Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar se do të zvogëlojnë praninë e tyre në Afganistan. Por misioni i NATO-s do të mbetet. Dhe ne do të vazhdojmë të sigurojmë mbështetje për forcat afgane të sigurisë. Asnjë aleat nuk dëshiron të qëndrojë në Afganistan për më shumë kohë nga sa është e nevojshme. Por ne nuk mund të rrezikojmë që Afganistani të bëhet edhe një herë një platformë për terroristët ndërkombëtarë për të planifikuar dhe organizuar sulme në vendlindjet tona. Ne nuk mund ta lejojmë ISIS-in të rindërtojë në Afganistan kalifatin terrorist që humbi në Siri dhe Irak. Prandaj ne do të adresojmë praninë e ardhshme të NATO-s në Afganistan në takimin tonë të ardhshëm të ministrave të Mbrojtjes në shkurt. Do të përballemi me një zgjedhje të vështirë. Ose qëndrojmë – dhe paguajmë çmimin e një angazhimi të vazhdueshëm ushtarak, ose largohemi – dhe rrezikojmë që fitimet që kemi bërë të humbin dhe se procesi i paqes

të çalojë. Kjo nuk është koha për të përfunduar. Por duhet të kujtojmë se kemi shkuar së bashku në Afganistan dhe kur të jetë koha e duhur, ne duhet të largohemi së bashku, në një mënyrë të koordinuar.

Prioriteti i dytë i NATO 2030 është forcimi i NATO-s si një Aleancë politike

NATO është i vetmi vend ku vendet e Evropës dhe Amerikës së Veriut takohen çdo ditë. Ne duhet të bazohemi në këtë dhe të përdorim NATO-n edhe më shumë si një forum për diskutim të sinqertë, mbi një gamë të gjerë të çështjeve të sigurisë, nga Rusia në Lindjen e Mesme dhe nga ndikimet e sigurisë së një Kinë në rritjen e ndryshimi i klimës dhe kontrolli i armëve, si dhe mënyrën se si kemi të bëjmë me teknologjitë e reja dhe përçarëse.

Që NATO të bëhet më e fortë politikisht, ne duhet të vazhdojmë të pranojmë se po, ne kemi dallimet tona. I kemi pasur në të kaluarën, dhe i kemi tani. Ne duhet të vazhdojmë të adresojmë çdo ndryshim sinqerisht, si aleatë dhe si miq. Kjo është ajo që ne kemi bërë, për shembull, në Mesdheun Lindor. NATO siguroi platformën për Greqinë dhe Turqinë për t'u bashkuar. Mbi bazën e së drejtës ndërkombëtare dhe solidaritetit të aleatëve, të krijojë një mekanizëm ushtarak de-konfliktual dhe për të anuluar disa stërvitje të planifikuara ushtarake. Ky lloj de-konfliktualiteti ushtarak mund të parandalojë incidente dhe aksidente të rrezikshme në Mesdheun Lindor. Kjo mund të krijojë mundësinë për diskutime politike dhe zgjidhje diplomatike për të adresuar mosmarrëveshjet themelore. Edhe në debatin më të nxehtë, nuk duhet të harrojmë se ajo që na bashkon është më e fortë se ajo që na ndan. Në fund të fundit, ne jemi aleatë të NATO-s, të përkushtuar në misionin tonë kryesor, për të siguruar dhe mbrojtur njëri-tjetrin, të përkushtuar ndaj vlerave tona thelbësore, Demokracia, Liria individuale dhe

Sundimi i Ligjit. Zëri ynë është më i fuqishëm kur qëndrojmë të bashkuar.

Prioriteti i tretë i NATO 2030 është marrja e një qasjeje më globale

